



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1802/12 prot.

Datë 04.08.2025

V E N D I M
Nr. 1001/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.08.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 944/2025, datë 22.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F me NIPT K32725211G dhe adresë: Lagjia “Haxhias”, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz, Tiranë.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “I.D.K-Konstruksion” SHPK, me NIPT K51408016J dhe adresë : Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bërxullë, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167, Vorë, Tiranë.

Operatori ekonomik “R. S. & M” SHPK, me NIPT K32203002I dhe adresë : Autostrada Tiranë-Durrës, Km.2.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 22.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.944/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alma Kodra” P.F duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 653 prot., datë 28.07.2025 protokolluar me tonën nr. 1802/8 prot., datë 30.07.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.944/2025 datë 22.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz. Të njëjtin informacion autoriteti kontraktor e ka përcjellë edhe me shkresën nr.670 prot., datë 31.07.2025, protokolluar me tonën me nr.1802/9 prot., datë 04.08.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 653 prot., datë 28.07.2025 protokolluar me tonën nr. 1802/8 prot., datë 30.07.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.944/2025 datë 22.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz. Të njëjtin informacion autoriteti kontraktor e ka përcjellë edhe me shkresën nr.670 prot., datë 31.07.2025, protokolluar me tonën me nr.1802/9 prot., datë 04.08.2025.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.944/2025 datë 22.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, duke kualifikuar operatorin ekonomik “Alma Kodra” P.F, në zbatim të vendimit Nr.944/2025 datë 22.07.2025, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Gjergj Mersini

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

